



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 18.03.2019 (e hënë) duke filluar në ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar tremujor të katërt Tetor - Dhjetor 2018;
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Vjetor 2018;
4. Raporti i Drejorisë së Arsimit për përfundimin e gjysëmvetorit të parë për vitin skollor 2018/2019;
5. Të ndryshme.


Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:13.03.2019
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

(Signature)



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 19.02.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, zyrtari për shërbime publike Bajram Abazi, zyrtari për arsim Ilir Mustafa, menaxheri i kompanisë EccoHigiena Naser Ibrahim, Sladjana Peric dhe Milorad Milosevic nga zyra e Kryetarit dhe përfaqësuesi i OSBE-së Edmond Hyseni.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar tremujor të katërt Tetor - Dhjetor 2018;
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Vjetor 2018;
4. Raporti i Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e gjysëmvetorit të parë për vitin skollor 2018/2019;
5. Draft Plani për Menaxhimin e Mbeturinave;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me rend dite?.

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga anëtarët prezentë të KPF-së.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Raportit Financiar tremujor të katërt Tetor - Dhjetor 2018;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: shpresoj se me kohë e keni pranuar materialin, do të mundohem shkurtimisht ta prezantoj gjërat më të rëndësishme të këtij raporti, të hyrat komunale totale janë 44,514.08€, i keni të paraqitura sektoret se nga janë të hyrat si nga tatimi në pronë, nga regjistrimi i automjeteve, nga lejet e ndertimit e kështu me radhë. Në faqen tjetër i keni mjetet e shpenzuara për këtë periudhë, mbi 472,000€ kanë qenë mjetet e planifikuara për paga dhe medita ndërsa kemi shpenzuar mbi 468,000€ në përqindje 99.24%, për mallra dhe shërbime kemi shpenzuar mbi 72,000€, për subvencione 2,000€ dhe për investime kapitale mbi 199,000€, me pas i kemi tabelat për secilen Drejtori por mendoj se do të jetë e tepert që ti prezantoj për secilen drejtori, nese keni ndonjë pyetje unë do tju pergjigjem, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic pasi përshëndeti të pranishmit tha: të raporti i Kryetarit e kemi një fjalë në gjuhën angleze Petty Cash dhe nuk po e kuptoj.

Sercan Todorovic tha: janë parat e gatshme.

Kryesuesi tha: e kam edhe une një pyetje për Drejtorin te pjesa me të hyrave ku janë taksat për vertetime shuma është nga 1€ ndërsa të hyrat janë 399.10€.

Sercan Todorovic tha: mundet me qenë ndonjë gabim teknik.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë nga antarët e KPF-së që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Raportit Financiar Vjetor 2018;

Kryesuesi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic tha: ju kërkoj falje që nuk keni pasur mundësi ta merrni materialin në gjuhën serbe pasi që njëri perkthyes është në pushim ndërsa tjetri është shumë i ngarkuar me raporte të Drejtorisë, nese arrijm që ta dergojm materialin për Kuvend do ta shqyrtojm raportin nese nuk arrijm që ta dergojm materialin atëher do ta shtyjm për muajin mars, ne versionin fizik nuk mujna me dergu nesor, ndërsa në formë elektornike besoj që pas nesor do ta merrni pasi që shqip e kemi raportin vetem në gjuhën serbe nuk e kemi.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi përshendeti të pranishmit tha: pasi që raporti financiar vjetor nuk është i pregaditur në gjuhën serbe mendoj që ne nuk kemi se çka të diskutojm dhe kjo pikë të shihet për muajin mars.

Sercan Todorovic tha: nuk e di sa u kuptova, por unë po propozoj që kjo pikë të shkoj në Kuvend dhe nese materialin e marrin edhe në gjuhën serbe e diskutojm në këtë Kuvend nese nuk e marrin atëher e shtym për muajin mars.

Selatin Nuhiu tha: ne na ka ardhur me kohë dhe e kemi materialin dhe në këtë buxhet kemi vërejtje shumë të mëdha, këtë buxhet siç e kam parë unë nuk ka asgjë të mirë 2,726,000€ janë të planifikuara ndërsa të realizuara janë 2,546,000€ dmth 6.61% e buxhetit nuk është shpenzuar, i kemi shpenzimet e gjykates 2,000€ për çka është kjo shumë?, lejet e ndertimit kanë shenuar rënje prej 27,000€, shfrytëzimi i pronës publike çdo vi prej vitit 2015 ka shenuar rënje ku vitin 2018 janë vetem 1,000€ dhe disa puntor paguhen prej mallrave dhe sherbimeve, çka është puna e këtyre punëtorëve, ne administrat paguhen dy punëtor prej mallrave dhe sherbimeve që mbi një vit janë kontart mbi veper, katër puntorë janë në sherbime publike kemi edhe shumë vërejtje tjera por le të shkon në Kuvend pastaj atje diskutojm.

Sercan Todorovic tha: sa i përket pytejes për ndertime nuk i kemi zvogluar ne por janë zvogluar ndertimet, kur i permendet të hyrat prej shfrytëzimit të pronës publike kan shënuar rënje për arsye se nuk i kanë paguar vitin e fundit por në ju kemi derguar shkresë të gjithëve dhe nese nuk e paguajn brenda afatit ju shkëpusim kontraten.

Selatin Nuhiu tha: i pash edhe borgjet që i ka Komuna vetem EccoHigines 14,500€ borgj, e di që ndoshta kanë shkuar përmes përmbaruesit por përmbarusi denon.

Sercan Todorovic tha: për vitin e kaluar i kemi pasur vetem 46,000€ për shpenzime Komunale pra kemi pasur pak mjete andaj nuk kemi qenë në gjendje që ti mbulojm të gjitha këto obligime që i kemi pasur, ato pare që përfshihen për shpenzime Komunale mundë ti shpenzojm për telefon, për rrym dhe për mbeturina, puntorët që i permende se kanë marrë pogë prej mallrave dhe sherbimeve i kemi një kontart me Ministrin e Punëve të Brendshme ku i kemi dy punëtor për regjistrim të automjetve dhe kontraten me kompanin e ujësjellësave dhe këta puntor i paguajn prej mallrave dhe sherbimeve. Pasi nuk pati diskutime aprovohet me 4 vota për 1 apstenim nga antarët e KPF-së kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e katërtë: Raporti i Drejorisë së Arsimit për përfundimin e gjysëmvetorit të parë për vitin skollor 2018/2019;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën zyrtarit për arsim Ilir Mustafa.

Për këtë pikë Kryesusi ja dha fjalën zyrtarit për arsim Ilir Mustafa.

Ilir Mustafa pasi përshendeti të pranishmit tha: për këtë raport është duhur të jetë Flamur Uka por ai gjendet në një takim zyrtar, sa i përket raportit në kemi pregaditur për shkollat shqipe por për shkollat serbe ende nuk e kemi pregaditur për arsye se e përfundojnë gjysëmvetorin më vonë., amdaj kërkoj nga ju që këtë pikë ta shtyni për muajin mars.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli pasi përshendeti të pranishmit tha: e kam vetem një pyetje se kur e përfundojnë shkollat serbe mësimin pasi që ky raport gjithmonë na vonohet.

Ilir Mustafa tha: edhe një javë e përfundojnë mësimin.

Xhejlane Behluli tha: propozoj që ky raport gjithmonë të vij në mars pro pasi që gjithmonë po kemi vonesë të materialit.

Selatin Nuhiu tha: nuk e di se kush e ka autorizuar këtë të vij unë kisha pasur dëshirë që të shoh këtu Drejtorin apo Drejtoreshen kush është pasi që është obligativ që të vij e jo përfaqësuesi dhe nese vjen në Kuvend ky raport pa drejtor është më mirë që ky raport të mos bihet fare, duhet të jetë shprehur që Drejtorat të vinë të raportojnë e jo të vinë zyrtarët Komunal.

Xhejlane Behluli tha: po flas për mandatin të kaluar Selatin dhe e di që Adem Abazi vetem njëherë ka marrë pjesë në raport dhe gjithmonë e ka dërguar Flamur Ukën që të raportoj si në KPF ashtu edhe në Kuvend, nuk jam duke e mbrojtur askën por me rendësi të na vij një raport dhe ta dimë se çka ka ndodhur me shkollat e tona.

Selatin Nuhiu tha: paske informata të gabuara pasi që Adem Abazit njëherë i kemi kërkuar raport dhe atë herë ka raportuar ai vet.

Kryesusi tha: duke pasur parasysh që raporti nuk është komplet propozoj që kjo pikë të shtyhet për muajin mars.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë nga antarët e KPF-së që të shtyhet për muajin Mars.

Pika e pestë: Draft Plani për Menaxhimin e Mbeturinave;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën zyrtarit në shërbime publike Bajram Abazit.

Bajram Abazi pasi përshendeti të pranishmit tha: së pari kërkoj falje që nuk e keni marrë materialin, pro ne kemi planifikuar që këtë draft plan ta dergojmë në Kuvend muajin e ardhshëm por arsyeja është që në gjuhen serbe nuk është përkthyer ende nga GIZI Gjerman dhe ne na është kërkuar tash nga Ministria e Ambientit që të konkurojmë në projekte për kontinjer dhe ne duhet ta kemi planin për menaxhimin e mbeturinave të aprovuar e në muajin mars hapet konkursi për projekte, për Kuvend do ta keni materialin në të dy gjuhët dhe do ta bëjmë prezantimin përmes monitorit në sllajde, nese ka mundësi që të votoni këtë pikë që të shkojë në Kuvend pasi që është në interes të qytetarëve.

Naser Ibrahim i menaxher i kompanisë EccoHigiena pasi përshendeti të pranishmit tha: vetem ta plotësoj pak Bajramin pasi që me 28 shkurt është afati i fundit që ta dorëzojmë në këtë plan dhe pastaj të aplikojmë për projekte dhe kjo është për të mirën e të gjithë qytetarëve, aty janë parapa që të blihen disa kontinjer shtëpiak, ky plan është për tre vite dhe janë të përfshira se për çdo vit se çka do të investohet.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: pak sa e shfletova e pash se është shumë i mirë si projekt dhe unë e përkrahi personalisht, suksese për punën e bërë.

Selatin Nuhiu tha: ky plan na ka ardhur pak për ngut dhe jo i kompletuar, pra nuk është plani edhe në gjuhen serbe, unë pajtohem që të shkojë edhe në Kuvend.

Naser Ibrahim tha: javën e kaluar e kemi pasur një takim dhe na kanë thënë që duhet ta kemi këtë plan të aprovuar, nuk është që ne jemi vonuar, ata e kanë pregaditur këtë plan dhe e kanë financuar, plani është pregaditur në bashkpunim me ne.

Selatin Nuhiu tha: ju përgëzoj për punën që keni bërë ju si zyrtarë Komunal dhe e di që keni punuar shumë që të vij ky projekt deri këtu por kishte qenë më mirë që të jetë edhe në gjuhen serbe.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohet njëzëri kjo pikë nga antarët e KPF-së që të shkojë në Kuvend.

Pika e gjashtë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic tha: procesverbalet e muajit nentor dhe dhjetor nuk i kemi marrë në gjuhën serbe.

Kryesuesi tha: nuk janë përkthyer.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

Procesëmbajtëse

Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës/Direkcija za Obrazovanju i Kulturu

DATË/A:	12.03.2019
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Novobërdës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Flamur Uka, Zyrtar për Personel dhe Financa në DAK
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë dhe fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2018/19

Të nderuar këshilltarë komunalë,

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, bazuar në obligimet e saja për të raportuar në periodha të caktuara kalendarike para këtij Kuvendi, sot po ju paraqesim raportin tonë lidhur me mbarimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018/19.

Më lejoni që për informimin tuaj, t'ju njoftoj se fillimi i gjysmëvjetorit të parë, ka qenë i rregullt dhe nuk ka pasur ndonjë problem që vlen të theksohet, shkollat janë furnizuar me materialet e nevojshme, janë shpallur konkurset sipas kërkesave dhe janë përzgjedhur punëtorët, pa ndonjë problem për procesin mësimor.

Sigurisht se problemet e vazhdueshme në sektorin e arsimit na kanë përcjellë edhe këtë gjysmëvjetor, siç është, sasia e vogël e buxhetit, në të gjitha kategoritë buxhetore, por më e ndjeshme ka qenë në atë të pagave dhe shërbimeve e mallrave. Dhe ka qenë ky fakt që na ka detyruar t'i shkurtojmë shpenzimet tona duke i furnizuar shkollat vetëm me material të domosdoshëm administrativ e teknik.

Por, përkundrejt këtyre sfidave dhe problemeve tjera që na janë paraqitur gjatë punës sonë të përditshme, ne si Drejtori e Arsimit dhe Kulturës, vlerësojmë së ky gjysmëvjetor i parë i vitit shkollor 2018/19 ka përfunduar me sukses, qoftë në aspektin teknik-administrativ qoftë edhe në atë të cilësisë së punës, përkushtimit profesional etj.

Këto konstatime tona mbështeten në rezultatet statistikore, në ruajtjen e funksionimit normal të punës së të gjitha shkollave, kontinuitetin e mësimi dhe mos ndërprerja e tij, përballimi me të gjitha sfidat, qoftë administrative apo financiare. Përballimi i transportit të nxënësve të të gjitha niveleve, sigurimi i mjeteve për ngrohje, pagimi i shërbimeve komunale, me disa borxhe të vogla të rrymës ndërsa për mbeturina na ka mbetur një pjesë më e madhe borxh për vitin 2019.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve përkundër kursimeve për këtë pjesë të vitit përkundër sfidave kemi arritur ti mbulojmë shpenzimet për transport, e cila kap shumë prej mbi 25,000 eurosh.

Por, pavarësisht të gjitha këtyre sfidave, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, me stafin e saj solid, ka bërë përpjekje që të përballlet me të gjitha problemet dhe vlerësojmë se gjysëmvetori i parë, përkundërt sfidave me të cilat na ka përballur, është një periudhë kohore e përmbyllur me sukses.

Ne, në këtë raportim, po përpiqemi që, si tërësi t'ju njoftojmë për ecurinë e procesit mësimor dhe sfidave që na janë paraqitur kurse detajet teknike janë përcjellë në sistemin e menaxhimit të informatave në Ministrinë e Arsimit, bashkë me raportin tonë, ku secila shkollë, veç e veç raporton çështje të dhënash që nevojiten për statistikën e Ministrisë së Arsimit për reflektim dhe hartim të politikave të reja arsimore e financiare.

Drejtori e Arsimit dhe Kulturës, konform përgjegjësisë së saja, i ka organizuar dhe mbajtur, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të gjitha aktivitetet e parapara në shkolla.

Drejtorja e Arsimit, në bashkëpunim me stafin e shkollave, në takimet e saja të rregullta ka punuar vazhdimisht në identifikimin e fenomeneve që ndikojnë në cilësinë e punës dhe rezultatin e saj. Disa nga këto fenomene janë, rënia e cilësisë dhe rezultateve të mira gjatë kalimit të nxënësve prej nivelit fillore në atë të mesëm të ulët si dhe numri i madh i mungesave, përkundërt një rënie të hetueshme të tyre.

Po ashtu, e kemi trajtuar edhe mundësinë e angazhimit më të madh të stafit mësimdhënës në punë plotësuese, në aktivitete të lira dhe kreative më nxënës si dhe ndjekjen e trendit modern të mësimdhënies, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Më poshtë po jua përcjellim numrin e punëtorëve në të gjitha shkollat e Komunës së Novobërdës:

Departamenti	Niveli	KODI BUXHETOR	KODI	MEF CONTROL	TOTAL
Novobërdë	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	10	92790	654	2
Novobërdë	F. "D. Obradovic"	10	93871	654	20
Novobërdë	F. MILADIN POPOVIC-NOVO BERD	10	93872	654	24
Novobërdë	F. SVETI SAVA-NOVO BERD	10	93873	654	2
Novobërdë	F. P.P. NJEGOSH-NOVOBERD	10	93874	654	35
Novobërdë	F. BORA STANKOVIQ-NOVOBERD	10	93875	654	24
Novobërdë	F. ASDRENI-NOVOBERD	10	93876	654	20
Novobërdë	F. MINATORI-NOVOBERD	10	93877	654	19
Novobërdë	F. NUSHI & TEFIKU-NOVOBERD	10	93878	654	25
Novobërdë	F. SVETI SAVA-PARALLOVE-N. BERD	10	93879	654	4
Novobërdë	Arsimi I mesëm	10	95072	654	11
Novobërdë	Shkolla e Mesme Ekonomike-Kufce-Novobërd	10	95073	654	14
Novobërdë	SHMT "Dragi Popoviq"-Kufce-Novobërd	10	95074	654	19

Total :

219

Të nderuar këshilltarë komunalë,

Në këtë raport ju kemi paraqitur disa të dhëna, vlerësojmë të rëndësishme dhe identifikuese të problemeve që ndërlidhen me cilësinë e punës në arsim. Ky gjysmëvjetor i parë ka përfunduar në mënyrë të rregullt sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi.

Edhe gjysmëvjetorit i dytë i vitit shkollor 2018/19 në aspektin teknik ka qenë në rregull, mirpo shkollat shqipe kanë filluar me grevë e cila është e organizuar nga SBASHK ku mësimi nuk është mbajtur për tri javë, ndërsa në shkollat serbe mësimi është mbajtur pa ndonjë ndërprerje.